

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Nesrin Lushta, kryetare, Valdete Daka dhe Agim Maliqi, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit S.K., nga fshati Q., komuna e L., për shkak të veprës penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KPK-së, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit S.K., avokatit V. S., ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë PKR.nr.7/2016 datë 17.8.2017 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PKR.nr.519/2017 datë 27.11.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më 30 prill 2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazë kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit S.K., ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë PKR.nr.7/2016 datë 17.8.2017 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PKR:nr.519/2017 datë 27.11.2017.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, PKR.nr.7/2016 datë 17.8.2017, i dënuari S.K., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm, nga neni 375 par.2 të KPK-së dhe për këtë vepër penale është gjykuar me dënim me gjobë në shumë prej 200 € si dhe me dënim me kusht ashtu që ia vërteton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muaj, të cilin dënim i dënuari nuk do ta mbajë, nëse në afat prej 1 (një) viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale. Ndaj të dënuarit është shqiptuar edhe dënimi plotësues, konfiskimi i pushkës së gjuetisë dy tytëshe e modelit Semiautomatike me numër serik 5155204 të kalibrit 12mm, si mjet i kryerjes së veprës penale, ndërsa i dënuari është liruar nga pagesa e shpenzimeve procedurale dhe paushallit gjyqësor pasi do të rrezikohej gjendja materiale e të dënuarit dhe familjarëve të tij që i mbështet ai materialisht.

Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit të Kosovës, me aktgjykimin PKR.nr.519/2017 e datës 27.11.2017, ka refuzuar ankesën e mbrojtësit të të dënuarit, ndërsa aktgjykimin e shkallës së parë e ka vërtetuar.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të dënuarit, av. V.S., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale që kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimeve gjyqësore, me propozim që aktgjykimet e kundërshtuara të ndryshohen dhe të dënuarin ta liroj nga akuza ose të anulohen dhe çështja të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë si dhe të shtyhet ekzekutimi i dënimit deri sa të vendoset në mënyrë meritore nga Gjykata Supreme e Kosovës.

Prokurori i Shtetit me parashtresën, KMLP.II.nr.51/2018 e datës 21.3.2018, ka propozuar që të refuzohet si e pabazë kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, pasi shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes e në kuptim të dispozitës së nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPPK, vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe konstatoi se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar.

Në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë mbrojtësi i të dënuarit av. Valon Sadiku pretendon se aktgjykimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.2 pika 2.1 lidhur me nenin 58 par.1 pika 1.2 të KPPK. Kjo shkelje konsiston në faktin se gjykata e shkallës së parë me rastin e gjykimin të dënuarit nuk i ka caktuar mbrojtës sipas detyrës zyrtare pavarësisht faktit se mbrojtja nuk ka qenë e obliguar e duke marrë parasysh llojin e sanksionit që parashihet për këtë vepër penale. Si shkelje të ligjit penal mbrojtja potencon se në dëm të të dënuarit është shkelur neni 385 par.1 pika 1.1 të KPK-së sepse i dënuari ka vepruar në mbrojtje të nevojshme kur ka shtënë në ajër për të frikësuar personin i cili ka tentuar të vjedhë në shtëpinë e tij.

Gjykata Supreme duke vlerësuar pretendimet e potencuar në kërkesë gjen se aktgjykimi i shkallës së parë nuk është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e cila pretendohet, sepse në rastin konkret mbrojtja nuk ka qenë e detyruar dhe ligjdhënësi ka paraparë rastet kur mbrojtja është e detyruar e sipas nenit 57 par.1 pika 1.1 të KPPK-së përveç tjerave parashihet se nga marrja në pyetje për herë të parë kur i pandehuri është memec, shurdh, i verbër ose shpreh shenja të çrregullimeve apo paaftësisë mendore dhe kështu është o paaftë mbrohet vet, atëherë gjykata i cakton mbrojtës të detyruar. Në rastin konkret asnjë nga këto situata nuk janë adekuate për të dënuarin dhe gjykata nuk ka pasur obligim të i caktoj mbrojtës, gjë që e bënë pretendimin të paqëndrueshëm.

Sa i përket pretendimeve për shkeljen e ligjit penal kjo gjykatë po ashtu gjen se këto pretendime nuk qëndrojnë sepse është e vërtetë se i dënuari ka shtënë me armë

natën kritike duke menduar se ka të bëjë me vjedhje në shtëpinë e tij, por për të ekzistuar mbrojtja e nevojshme nuk mjafton që një person të konsideroj se ka sulm por sulmi duhet të jetë real, i jashtëligjshëm i atëçastshëm dhe personi duhet të veprojë që të mënjanoj sulmin nga vetja apo të afërmit e tij e sipas dispozitës së nenit 12 të KPK. Në rastin konkret e sipas deklaratës së të dënuarit ai e ka pa një person të panjohur i cili e ka qel derën e shtëpisë së tij dhe në momentin kur e ka thirre me emër të djalit “Bahri” duke menduar se është ai, personi ka ikur dhe ka shkuar prapa shtëpisë së tij dhe ka kaluar në oborrin e shtëpisë së fqinjëve. Sipas deklaratës së dhënë në prokurori me datën 22.9.2015, ngase në shqyrtim gjyqësor i dënuari e ka pranuar fajësinë në tërësi dhe provat nuk janë administruar, vet i dënuari e vërteton se kur ka shtënë në ajër, personi i panjohur ka arritur të largohet nga oborri i shtëpisë. Andaj, i dënuari nuk ka mundur të veprojë në mbrojtje të nevojshme sepse asnjë nga kushtet ligjore për ekzistimin e saj nuk janë plotësuar, pra, sulmi nuk ka ekzistuar në momentin kur ai ka shtënë.

Nga të gjitha këto që u thanë më lartë e duke mos gjet shkelje të ligjit penal në dëm të të dënuarit kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë u konsiderua si e pabazuar dhe konform nenit 437 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.72/2018, më 30 prill 2018

Procesmbajtësi,

Bujar Balaj

Kryetare e kolegjit,

Nesrin Lushta